



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organ Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga “MIGJENI” (ish-Banka e Ljubllanës) Kati V-të,
Prishtinë, Kosovë

Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. nr. 40/23

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092), në përbërje nga Vjosa Gradinaj-Mexhuani - Kryetare, Vedat Poterqoi- Referues dhe Agon Ramadani- Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik (OE) “Pe -Vla-Ku” sh.p.k, dega në Kosovë- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Rrënimi-Ekzekutimi i objekteve të ngritura pa leje ndërtimi-Ilegale dhe shërbime tjera” me numër të prokurimit 632-22-11389-5-2-1, iniciuar nga Komuna e Gjakovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK), me 26.04.2023, mori këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa e parashtruar nga operatori ekonomik “Pe -Vla-Ku” sh.p.k, dega në Kosovë-Prishtinë, e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 16.01.2023 (me numër protokolli 40/2023) për aktivitetin e prokurimit me titull: “Rrënimi-Ekzekutimi i objekteve të ngritura pa leje ndërtimi-Ilegale dhe shërbime tjera” me numër të prokurimit: 632-22-11389-5-2-1, iniciuar nga AK– Komuna e Gjakovës.
2. Anulohet, Njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit me titull: “Rrënimi-Ekzekutimi i objekteve të ngritura pa leje ndërtimi-Ilegale dhe shërbime tjera” me numër të prokurimit: 632-22-11389-5-2-1, inicuar nga Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, ndërkaq aktiviteti i prokurimit me të dhënat si më sipër shënuar kthehet në rivlerësim.

3. Në afat prej 10 ditësh, AK detyrohet ta informoj OSHP, për zbatimin e këtij vendimi për këtë aktivitet të prokurimit përshkruar si në paragrafin paraprak të dispozitivit. Në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarr masa ndaj AK për mos respektim të vendimit, sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (versioni i konsoliduar). Njoftimi për zbatimin e vendimit i dërgohet ne imellen zyrtare te Organit shqyrtues të Prokurimit nga zyrtari përgjegjës i prokurimit konform nenit 105, paragrafi 2.12 të LPP¹

4. Me qenë se ankesa e OE “Pe -Vlaku” Sh.P.K, aprovohet si e bazuar sipas arsytimit të vendimit, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

5. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 30.12.2022, Komuna e Gjakovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin mbi vendimin autoritetit kontraktues për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit “Rrënimi-Ekzekutimi i objekteve të ngritura pa leje ndërtimi-Ilegale dhe shërbime tjera” Nr prokurimit 632-22-11389-5-2-1, në të cilin ishte rekomanduar për kontratë GOE N.P.Sh.”Eltoni Com”& I Seferi Sh.P.K, me seli në Gjakovë.

Me 04.01.2023, OE “Pe-Vla-Ku” Sh.p.k, kishte parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë AK-Komuna Gjakovë, e cila është refuzuar si e pa bazuar me 11.01.2023, duke vërtetuar njoftimin mbi vendimin autoritetit kontraktues i datës 30.12.2022.

Me 16.01.2023 Operatori Ekonomik “Pe -Vla-Ku” sh.p.k, ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 40/2023, kundër njoftimit mbi vendimin e AK për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Me rastin e shqyrtimit paraprak, Paneli Shqyrtues konstatoi se, ankesa në rastin konkret është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë në OSHP vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji.

¹<https://oshp.rks-gov.net/sq/ProcurementActivities/Search>

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 17.01.2023, eksperti i jashtëm shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- Ankesa OE “Pe -Vla-Ku” sh.p.k të aprovohet si e bazuar,
- Të anulohet Njoftimi mbi Vendimin e AK-së të datës 30.12.2022 (*vendimi për dhënie të kontratës*) ndërkaq aktiviteti i prokurimit me të dhënat si më sipër shënuar të kthehet në rivlerësim.

Duke vepruar mbi bazën e parimeve të përgjithshme të parapara me nenet 6 dhe 7 dhe parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të Ligjit të cituar dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, konstatohet se:

- AK ka zbatuar procedurë të hapur të tenderimit, me kriteret si në vijim: lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës 202 550,00 €
- Në këtë aktivitet të prokurimit kanë marr pjesë 4 grupe të operatorë ekonomik. Tenderi me çmim më të lartë përmbante vlerën 186,050.00 € ndërsa tenderi me çmim më të ulët përmbante vlerën 89,660.00 €.
- Pretendimet kryesore mbi bazën e të cilave është ushtruar ankesa, janë drejtuar në atë se autoriteti kontraktues ka rekomanduar për kontratë një OE të papërgjegjshëm administrativisht duke vepruar në kundërshtim me nenin 1,7,59,60,61,69,72 të LPP lidhur me nenin 39 të Rrups për tenderët apnormalisht të ulët,

- Seanca Dëgjimore –

Paneli Shqyrtues konsideroj se lidhur me çështjen në rastin konkret, duhet të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa deklaratimet e palëve në seancë, do të krijojnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritues, andaj paneli shqyrtues i OSHP-së, me datën 13.03.2023 mbajti seancë dëgjimore.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të Ankuesit, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklaratimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe administrimit të provave në tërësi, e të gjithë aktivitetit të prokurimit të lartë shënuar si vijon:

Pretendimi kryesor mbi bazën e të cilit ankuesi i është drejtuar OSHP, konsiston në atë se AK me vendimin e datës 05.12.2022 kishte rekomanduar një Oe për kontratë I cili nuk I plotëson kriteret e dosjes së tenderit.

Ankuesi pohon se AK ka kishte kërkuar sqarime nga i rekonaduari duke kërkuar që për inxhinierin e Elektrikës të propozonte diplomën e noterizuar dhe kontratën e punës me punëdhënësin për këtë projekt (origjinal ose kopje të noterizuar) kurse në lidhje me këto sqarime i rekomanduri kishte ofruar si dëshmi kontratën dhe diplomën e noterizuar e të cilat sipas ankuesit kishin qenë pjesë e dosjes së tenderit, po ashtu ka bashkangjitur edhe CV e cila ishte bashkangjitur ne dosje por e njehta nuk ishte sipas kërkesës ngase me këto dëshmi nuk mund të dëshmohet përvoja e punës së inxhinierit në fjalë dhe nuk ka ofruar asnjë referencë, duke shpjeguar me tej se i rekomanduari nuk ka ofruar kontratën e noterizuar ndërmjet dy palëve për këtë projekt siq ishte kërkuar në DT dhe rjedhimisht kjo kërkesë e cila nuk ishte plotësuar nga i rekomanduari e bënë të papërgjegjshëm për këtë aktivitet.

Lidhur me këtë pretendim ekspertit shqyrtues sqaron se AK në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit të Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale neni 9.1 & 9.2 III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional kishte kërkuar që Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka së paku 10 (dhjetë) punëtorë të mjaftueshëm si dhe të ketë staf profesional për kryerjen e projektit a.) një inxhinier i diplomuar apo master i ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv ose arkitekturës me provoj pune 3 vjeçare pas diplomimit b.) një inxhinier i diplomuar apo master i ndërtimtarisë drejtimi hidroteknikë me provojë pune 3 vjeçare pas diplomimit c.) një inxhinier i diplomuar apo master i elektroteknikës me provojë pune 3 vjeçare pas diplomimit, d.) një gjeodet ose teknik të gjeodezisë (gjeometër) me provojë pune 3 vjeçare pas diplomimit. Kurse si dëshmi kishte kërkuar Lista e kualifikimeve shkollore dhe profesionale e personelit profesional të dëshmohet me CV, diplomë dhe kontrata të punës apo në rast të lidhjes së kontratës mbi vepër duhet specifikuar titullin e projektit për të cilin lidh kontratë (origjinal ose të noterizuar). Eksperti sqaron se AK gjatë vlerësimit të tenderit kishte konsideruar të nevojshme të kërkojë sqarime sipas nenit 72 të LPP për stafin profesional me Letër standarde e kërkesës për informata mbi tenderët tri herë dhe atë me datën 29.11.2022; kërkesën e datës 23.12.2022 si dhe letrën standarde të datës 27.12.2022 për plotësim të dokumentacionit.

Operatori ekonomik N.P.Sh "Eltoni Com"& Iseferi SH.P.K për stafin e propozuar në bazë të kërkesës për informata mbi tenderët për stafin e propozuar si në vijim:

- Për inxhinier të diplomuar të Hidroteknikës (z....)² kishte dorëzuar diplomën Nr. 67 të datës 2 shkurt 2017 e noterizuar Nr- LRP. nr. rendor 3156/2022 me 03.03.2022 nga noter Sevdije S. Krasniqi, e cila e plotëson kërkesën e kërkuar. Kontratën për punësim në mes të N.P.Sh. Eltoni Com dhe (z....)³ të datës 07/11/2022 ne origjinal si dhe CV-në, që plotëson kërkesën e kërkuar të AK.

-Për gjeodetin e propozuar (z....)⁴ kishte dorëzuar Licence për kryerjen e shërbimeve kadastrale Nr. 23 të datës të dhënies 03.03.2020, me afat të skadimit 03.03.2025, Diplomën nr.1609 të datës 20 korrik 2017 të noterizuar Nr- LRP. Nr. rendor 10734/2022 të datës 23.08.2022 nga noter z. Arber Sadiku, që plotëson kërkesën e kërkuar. Kontratën mbi vepër për këtë projekt e lidhur në

² Emri në shkresa të lëndës

³ Emri në shkresa të lëndës

⁴ Emri në shkresa të lëndës

mes të N.P.Sh. Eltoni Com dhe z... të datës 07/11/2022, kopje e noterizuar LRP. Nr. 14729/2022 nga noteri Arber Z. Sadiku dhe poashtu CV-në e cila i plotëson kërkesën e kërkuar në DT

-Për inxhinier të diplomuar të Elektrikes (është kërkuar diploma e noterizuar) kontrata me punësim për këtë projekt (origjinal ose kopje e noterizuar), I rekomanduari ka dorëzuar Diplomën nr.191 të datës 8 mars 2005 të noterizuar LRP. Nr.12703/2018 të datës 23.07.2018 për (z....)⁵ nga noteri Valbona Y. Murtezi Bytyqi, e cila i plotëson kërkesën e kërkuar. Kontratën për punësim lidhur me mes të N.P.Sh. Eltoni Com me seli ne Gjakove dhe z.... të datës 07/11/2022 në origjinal, e cila i plotëson kërkesën e kërkuar, si dhe CV-në, e cila i plotëson kërkesën e kërkuar të AK.

Bazuar në informatat shtesë të ofruara, paneli shqyrtues konform ekspertit sqaron se i rekomanduari për kontratë ka arritur të dëshmojë me dëshmi se i njejtë i plotëson kërkesën për kapacitetin teknik dhe profesional, duke sqaruar se në DT nuk ishte kërkuar që kontrata të jetë e noterizuar tek noteri (por vetëm kopja nëse prezantohet të vertetohet e noterizuar nga origjinali), jo ashtu siq pretendon ankuesi, duke pohuar me tej se i rekomanduari ne ofertën e ti ka prezantuar në origjinal kontratat e kontestuara, prandaj pretendimi në këtë pikë i Ankuesit, është i paqëndrueshëm.

Sa i përket pretendimit ankimor se AK, në raport të vlerësimit dhe rivlerësimit deklaron që fitues është shpallur "NPSH Eltoni Com & I Seferi SHPK, ndërsa nga formulari i tenderit, njoftimi mbi vendimin e AK-së, raportet e vlerësimit kuptohet se lider i grupit të konzorciumit është OE N.P.SH. Eltoni Com dhe jo I Seferi Sh.P.K, pavarësisht faktit që në njërin nga deklaratat e grupit të OE shkruan se lider është OE Iseferi Sh.P.K, Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se sipas nenit 11.1 tek DT Krijimi i një grupi të operatorëve ekonomik citohet: pika c). *Një deklaratë të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit të cilët autorizojnë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit.* Në rastin konkret, grupi i operatoreve ekonomik "NPSH Eltoni Com & Iseferi Shpk duke u bazuar ne nenin e cituar ka nënshkruar një deklaratë nga të gjithë anëtarët e grupit të cilët kanë autorizuar liderin e grupit "Iseferi" SH.P.K. me seli në Suharekë si dhe z. B.. I..⁶ i cili ishte autori i paraqes të gjitha dokumentacionin e nevojshëm tek Autoriteti Kontraktues, të lidh kontratën me investitorin, të ndjek punimet ne objekt deri ne përfundim e tyre dhe dorëzimin e objektit investitorit, andaj edhe pretendimi ankimor për këtë pikë, është i paqëndrueshëm dhe i pabazuar në dispozita ligjore, rrjedhimisht paneli mbështet raportin e ekspertit.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se AK – Komuna e Gjakovës, ka propozuar për kontratë grupin e OE ku lider i grupit është NPSH Eltoni Com, atëherë kërkesa e lartcekur nuk është plotësuar nga grupi i OE të rekomanduar për kontratë, pasi që kërkesa ka qenë që në rast të grupit të OE lideri duhet të ofroj 60% e kontratave, ndërkaq i rekomanduari ka prezantuar një listë të kontratave ku vlera totale e kontratave është në shumën 110,270.00€, po ashtu lista e prezantuar nuk e plotëson kërkesën që lideri të posedoj 60% të kontratave, pasi që 60% i vlerës së kërkuar është në shumën 177,000.00 €.

Paneli shqyrtues konform ekspertit lidhur me këtë pretendimin ankimor sqaron se AK në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit tek Kriteret për Vlerësim të Kërkesat mbi mundësitë teknike

⁵ Emri në shkresë të lëndës (Nr protokoll 40/2023)

⁶ Emri në shkresë të lëndës (Nr protokoll 40/2023)

dhe/ose profesionale neni 9.1 & 9.2 kishte kërkuar: *Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontratë. Në një vlerë prej jo më pak se 295.000,00€, në rast konsorciumi lideri duhet të ketë të paktën 60% kontrata të natyrës së ngjashme. Ndërsa si dëshmi kishte kërkuar: Lista e kontratave në të cilën specifikohen të gjitha punët e realizuara në 3 (tri) vitet e shkuara, duke saktësuar punët e kryera shumë e kontratës, datën e pranuesit ose certifikatën e ekzekutimit të mirë të punëve (referencë ose raport të pranimi të punëve e cila përputhet me listën e dorëzuar), në rast se operatori ekonomik prezanton kontrata dhe referenca me operator ekonomik privat atëherë operatori ekonomik duhet të prezanton situacionet e nënshkruara së bashku me transaksionin bankar, që përputhen me të njëjtën kontratë-referencë.*Lideri i grupit OE “I Seferi” Sh.P.K ka dorëzuar listën e kontratave të punimeve të kryera, dhe referencat ne shumen prej 1,462,736.46 € të cilat kryesisht janë të mjaftueshme për këtë aktivitet të prokurimit (prezantuar në raport të listuara), andaj pretendimi ankimor edhe në këtë pikë cilësohet i pabazuar.

Tutje, lidhur me pretendimin se AK, ka propozuar për kontratë grupin e OE NPSH “Eltoni Com & I Seferi” SHPK i cili nuk e plotëson kërkesën në lidhje me autovinçin, pasi që në ofertë nuk ka të prezantuar dëshmi që e posedon autovinçin e kërkuar, paneli shqyrtues sqaron se AK në nenin 9.1&9.2 kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, kishte kërkuar që operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se kanë në dispozicion ose kontratë mbi qiramarrjen për këto mjete-pajisje teknike për realizimin e kontratës. Paneli shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar në Listën e pajisjeve nuk e ka të prezantuar autovinçin, mirëpo meqenëse autovinçi i kontestuar është prezantuar në ofertën e të rekomanduarit mund të konsiderohet si devijim konform nenit 59.4 të LPP.

Me tej Ankuesi pohon se AK edhe pse kishte aprovuar pjesërisht kërkesën e ankuesit për rishqyrtim, gjatë rivlerësimit nuk ka kërkuar sqarime shtesë për dëshmi dhe elemente tjera shumë me rëndësi siq janë sqarime për cmime apnormalisht të ulëta pra AK nuk ka zbatuar drejt nenin 59.2 dhe 72 po ashtu nuk është zbatuar as neni 61 të LPP.

Ndërkaq lidhur pretendimin e Ankuesit se AK ka propozuar për kontratë grupin e OE i cila ka ofertuar me çmim jo normalisht të ulët, paneli shqyrtues deklaroi se AK-ja ka qenë e obliguar të veprojë në bazë të nenit 61 të LPP dhe 42. Tenderët Jo-normalisht të Ulët të Rregullat Dhe Udhëzuesi Operativ Për Prokurimin Publik, lidhur nenin 3 të rregullat për tenderet apormalisht të ulët në të cilën parashihet cituar 3.1 *Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar, kur të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme: çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm; çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët; janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë. Tutje 3.2 Kur tenderët duken të jenë jo-normalisht të ulët për arsye të tjera nga ato të parashikuara në paragrafin 3.1 të këtyre rregullave, autoritetet kontraktuese mund të vlerësojnë besueshmërinë e tenderëve të tillë dhe rrjedhimisht të kërkojnë shpjegime në përputhje me paragrafët e mëposhtëm dhe nenin 61 të LPP-së.* Ngase kjo rregullore ishte në fuqi në momentin e incimit të këtij aktiviteti të dt.19.10.2022 Bazuar në këto të dhëna, paneli shqyrtues vlerëson se AK gjatë rivlerësimit duhet të kërkojë nga operatorët ekonomik për të

shpjeguar çmimin e ofruar për tenderët e përgjegjshëm, pasi sipas raportit të ekspertit janë përmbushen të gjitha kushtet, sipas dispozitës së lartcitur, për të vërtetuar nëse kanë ofruar çmime manipulative apo jo normalisht të ulëta, dhe kjo çështje është kompetencë e AK.

Lidhur me pretendimin e Ankuesit se GOE N.T.SH. "Marash -Shped" SH.P.K. & Company Zuka Commerce Sh.P.K. & Hagi Sh.P.K., janë të papërgjegjshëm për fakte pa nevojë që ato të prezantohet serish, Paneli Shqyrtues sqaron se AK këtë grup të operatoreve ekonomik e kishte vlerësuar administrativisht si të pa përgjegjshëm dhe tenderi u ishte eliminuar, me arsyetimin se nuk iu ishin përgjigjur kërkesës së bërë nga AK për sqarime sipas nenit 72 të LPP edhe pse ishin njoftuar për një veprim të till, andaj në këtë pikë vlerëson se ky GOE nuk mund të interesohet si palë interes juridik material sipas nenit 4. 1.26 i LPP për këtë aktivitet të prokurimit .

-Përfundim -

Paneli shqyrtues pasi që analizoj të gjitha pretendimet ankimore një nga një dhe vlerësoj sqarimet e dhëna nga eksperti shqyrtues, vlerëson se AK me zhvillimin e kësaj procedure të prokurimit, nuk ka vepruar në harmoni me dispozitat e nenit 59 dhe 72, ku parashihet që secili tenderues përmes kërkesës me shkrim të kërkuar nga autoriteti kontraktues, të ofrojë sqarimet shtesë të nevojshme, në një procedurë të prokurimit. Po ashtu sipas Rregullore për prokurimin publik neni 45.29 parasheh cituar: Për tenderët që plotësojnë kërkesat në lidhje me përgjegjshmërinë formale, kushtet teknike, përshkrimin dhe specifikimet e dosjes së tenderit, dhe vlersimin financiar, autoriteti kontraktues do të vazhdojë për të vlerësuar/verifikuar përshtatshmërinë, dhe nëse është e aplikueshme, kualifikimet e ofertuesve sipas kritereve të përzgjedhjes të specifikuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, në bazë të provave të nevojshme dokumentuese. 45.30 Verifikimi i përshtatshmërisë, dhe nëse është e aplikueshme, kualifikimeve të ofertuesit, bëhet përmes Letrës standarde B45 "Kërkese për sqarimin e tenderit" përmes platformës elektronike.

Nisur nga të lartcekurat dhe duke ju referuar shkresave të kësaj lënde, Paneli vëren se AK nuk ka kërkuar shpjegim me shkrim nga i rekomanduari për cmimet e ofruara dhe ka rekomanduar ofertën duke mos e arsyetuar veprimin dhe/ose aktin në rastin konkret edhe pse ishte ngritur si pretendim nga ankuesi, mbi bazën e dispozitave ligjore. Po ashtu, AK nuk ka respektuar Rregullat për tender jo-normalisht të ulët respektivisht nenin 4 Procedura e shqyrtimit (*inter-partes*), për të njëjtat arsye, duke mos kërkuar shpjegim me shkrim nga OE për çmimet e ofruar.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues në pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, kurse Vendimi sikurse në pikën 2, të dispozitivit është marrë në kuptim të nenit 31, paragrafi 6, i Rregullores së punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Kryetarja e Panelit Shqyrtues
Vjosa Gradinaj Mexhuani



KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK Komuna Gjakovë

1x1 OE "PE -VLA-KU" sh.p.k, dega në Kosovë-Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.